

Data 05/03/2026.

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS:**

« “Blerje goma + pjese xhenerike,mirembajtje mjetesh” »

**VLERA E FONDIT LIMIT:**

**2 917 850 (dy milion e nentëqind e shtatëmbëdhjetë mijë e tetëqind e pesëdhjetë) leke pa TVSH**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Librazhd ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

1. **Ofertuesi duhet të paraqesë:**

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

c) Formularin e ofertes ekonomike.

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2. **Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

2.1. **Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):**

**Sipas kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit.**

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

## 2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Xhiroja mesatare vjetore për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vite të fundit financiare, duhet të ketë një vlerë të pakten 40 % të vlerës së parashikuar të kontratës, pa përfshirë vlerën e TVSH-së, për të cilin duhet të paraqitet vërtetim i lëshuar nga administrata tatimore. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëqë Operatorët Ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të pakten një vit të periudhës së kërkuar nga AK si më lart.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Nenin 44, pika 1, paragrafi b), si dhe neni 64 i Ligjit Nr. 9920, datë 19.5.2008 (i ndryshuar) “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, në zbatim të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklarave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”, si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” etj.

**Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë vërtetimin e informacionit të paraqitur në zbatim të Ligjit nr.162/2020 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.**

## 2.3 Përvoja e ngjashme :

2.3.1. Për të provuar përvojën e mëparshme, OE duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Vlera e kërkuar për realizimet e mëparshme duhet të jetë të minimalisht deri në 20% e vlerës së kontratës që po prokurohet dhe që janë realizuar gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Për këtë OE duhet të paraqesë si dëshmi për përvojën e mëparshme,

- Vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara. (Për kontratat në sektorin publik).
- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën minimalisht 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

### **Aftesite teknike dhe profesionale**

2.3.2.Operatori Ekonomik te kete te punesuar te pakten 1 punonjes, me profesion mekanik, i pajisur me certificate profesionale per ushtrimin e kesaj detyre nga institucionet shteterore kompetente apo institucione private te akredituara dhe te njohura ne RSH. Punonjesi/it te jete/te i/te siguruar ne perputhje me legjislacionin ne fuqi per sigurimet shoqerore .

**Sqarim per ofertuesit** : Ne respektim dhe zbatim te **Ligjit nr.162/2020 date 23.12.2020 “ Per Prokurimin Publik ” neni 82 dhe VKM nr. 285, date 19.05.2021 ” Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”,i ndryshuar, neni 26 neni 39**, Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, **autoriteti kontraktor pranon si provë paraprake**, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së dhe nenit 26 te VKM nr.285, date 19.05.2021, te ndryshuar. **Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti kontraktor do t’i kërkoje ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike . Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësura me origjinalin.**

2.3.3.Disponimi i te pakten nje pike servisi per mjetet e transportit, ne territorin e Bashkise Librazhd ne pronesi ose me qera , te pasqyruar ne ekstraktin historik ne QKB.

2.3.4.Deklarate qe Operatori Ekonomik merr persiper te realizoje furnizimin e mallrave dhe sherbimin e montimit te pjeseve te kembimit /xhenerike, objekt prokurimi sipas kerkesave te Autoritetit Kontraktor dhe brenda afatit kohor te percaktuar nga AK .

2.3.5.Operatori ekonomik duhet te paraqese nje deklarate qe pjeset e kembimit qe do te perdoren per riparimin e automjeteve jane te reja dhe te prodhuara sipas standarteve te CE.

- **Shenim: Operatori Ekonomik , do te kryejë edhe sherbimin e montimit te pjeseve xhenerike apo vendosjen e gomave per mjetet e transportit te Bashkise Librazhd dhe Njesive te saj Vartese sipas nevoja te AK.**

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 40, pika 5, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë kapacitetet teknike dhe aftësitë profesionale ne permbushjen dhe realizimin e kontrates, si edhe garantimin e cilësisë së produkteve objekt kontrate dhe realizimin ne kohe te sherbimit.

#### **2.4.Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim.**

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

**Ne respektim te nenit 36, 37 te LPP-se ne te gjitha rastet kur permendet “marke” perfshihet termi “ekuivalent”.**

**Sqarim per ofertuesit :** Ne respektim dhe zbatim te Ligjit nr.162/2020 date 23.12.2020 “ Per Prokurimin Publik ” neni 82 dhe VKM nr. 285, date 19.05.2021 ” Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”, neni 26 neni 39, Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, **autoriteti kontraktor pranon si provë paraprake**, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së dhe nenit 26 te VKM nr.285, date 19.05.2021, te ndryshuar. **Në çdo rast, përpara se të publikojë njoftimin e fituesit dhe përpara nisjes së afatit të ankimit , autoriteti kontraktor detyruesisht do t’i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë**

**elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.**

## **II. Argumentimi i specifikimeve teknike**

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

*Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.*

*Te dhenat e mëposhteme janë përgatitur nga komisioni i përlogaritjes së vlerës së fondit limit dhe hartimit të specifikimeve teknike.(bashkangjitur DST)*

**Shënim :** Në rastet kur citohet në specifikimet teknike termi “marke” ose “ Cilesia e pare”, ky përcaktim është i barasvlefshëm me termin “ ekuivalente”.